

Në bazë të nenit 28 paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18) dhe nenit 5 paragrafi (1) të Ligjit për kontrollin e ndihmës shtetërore (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 145/10), Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në seancën e mbajtur më 23.6.2020, solli

MENDIM

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme "Komisioni") nga dhënësi i ndihmës shtetërore - Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes ministres pa portofol, përgjegjëse për investimet e huaja Zorica Apostolska (në tekstin e mëtejme: "Dhënës i Ndhmës", ka pranuar Kërkesë për mendim me nr.03-118/1 të datës 28.05.2020, lidhur me propozimin e marrëveshjes për ndihmë shtetërore nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut për pranuesin e ndihmës - Kompania VIK MACEDONIA SHPKNJF f. Alinci, Prilep (në tekstin e mëtejme: "Propozim Marrëveshja"), për projektin e dytë investues, i cili është dorëzuar në bashkëngjitje të Kërkesës për mendim së bashku me letrën e qëllimit nga marrësi i ndihmës shtetërore.

Komisioni shqyrtoi Propozim-marrëveshjen e dorëzuar, që parashikon dhënien e ndihmës shtetërore përmes tetë masave të cilat Dhënësi i ndihmës i ka specifikuar në Kërkesën për mendim, përkatësisht:

- 1. Lirim nga pagesa e tatimit mbi fitimin për një periudhë deri në 10 vjet;**
- 2. Lirim nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale në bazë të pagave të paguara për punonjësit për një periudhë deri në 10 vjet;**
- 3. Lirim nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar;**
- 4. Lirim nga pagesa e detyrimeve doganore;**
- 5. Lirim nga detyrimi për dhënien e një garancie si instrument për sigurimin e borxhit doganor;**
- 6. Lirim nga tarifa për rregullimin e tokës ndërtimore;**
- 7. Ndhimë në vlerë deri në 10% të shumës së investimeve fillestare ose investimeve shtesë të realizuara, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë në denarë në një periudhë 5 vjeçare dhe**
- 8. Ndhimë shtesë në shumën prej 10% të shumës së shpenzimeve të arsyetuara investuese, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë në denarë në afat prej 5 vitesh.**

Komisioni konsideron se masat:

- 1. Lirim nga pagesa e tatimit mbi fitimin për një periudhë deri në 10 vjet;**
- 2. Lirim nga pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale në bazë të pagave të paguara për punonjësit për një periudhë deri në 10 vjet;**
- 3. Lirim nga pagesa e tatimit mbi vlerën e shtuar;**
- 4. Lirim nga pagesa e detyrimeve doganore;**

5. **Lirim nga detyrimi për dhënien e një garancie si instrument për sigurimin e borxhit doganor;**
6. **Lirim nga tarifa për rregullimin e tokës ndërtimore;**

të përmendura në nenin 3 të Propozim-marrëveshjes paraqesin dhënie të ndihmës shtetërore nëpërmjet skemës së ndihmës së parashikuar në Ligjin për Zonat Zhvillimore Teknologjike-Industriale, dhënia e së cilës nuk kërkon miratim shtesë nga Komisioni i Mbrojtjes së Konkurrencës, duke pasur parasysh faktin se me Vendimin nr. 10-413/2, të datës 04.11.2008, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës miratoi Ligjin për Zonat Zhvillimore Teknologjike-Industriale si skemë e ndihmës për dhënien e ndihmës shtetërore për shfrytëzuesit e zonave zhvillimore teknologjike-industriale të themeluara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

Lidhur me masën

7. **Ndihmë në vlerë deri në 10% të shumës së investimeve fillestare ose investimeve shtesë të realizuara, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë në denarë në një periudhë 5 vjeçare**

e parashikuar në nenin 3.3 të Propozim-marrëveshjes, Komisioni konstatoi se e njëjta paraqet **ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore, sepse nuk është ndihmë shtetërore që jepet në bazë të një skeme ndihme, por i nënshtrohet miratimit shtesë nga Komisioni. Në nenin 4.5 të propozim-marrëveshjes, përfituesi i ndihmës obligohet të mbajë investimin për një periudhë të paktën pesëvjeçare duke llogaritur nga data e përfundimit të projektit investues, që është në përputhje me nenin 6 (1) të Rregullores për kushtet dhe procedurën për dhënien e ndihmës rajonale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, nr. 109/13).

Masa

8. **Ndihmë shtesë në shumën prej 10% të shumës së shpenzimeve të arsyetuara investuese, por jo më shumë se 1.000.000 euro në kundërvlerë në denarë në afat prej 5 vitesh.**

parashikohet në nenin 3.4 të Propozim-marrëveshjes si ndihmë shtesë shtetërore, pavarësisht ndihmave tjera shtetërore të marra në përputhje me Propozim-marrëveshjen.

Ashtu si masa e mëparshme, edhe kjo masë paraqet **ndihmë individuale** në kuptim të nenit 4 paragrafi (1) pika 2 të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore, sepse nuk është ndihmë shtetërore që jepet në bazë të një skeme ndihme, por i nënshtrohet miratimit shtesë nga Komisioni.

Kushti për dhënien e ndihmës shtetërore në Propozim-marrëveshjes është nëse marrësi i ndihmës investon një shumë totale prej së paku 2,500,000 euro si shpenzime të arsyetuara investuese deri në datën e përfundimit të projektit investues (neni 4.1 i Propozim-marrëveshjes) por jo më vonë se fundi i vitit të pestë nga data e fillimit të Marrëveshjes, gjegjësisht nga data 19.05.2020 (neni 1.1 i Propozim-marrëveshjes). Nëse deri në datën e përfundimit të projektit investues, përfituesi i ndihmës nuk arrin të realizojë të paktën 80% të kësaj shume, i njëjti do të paguajë një gjobë në shumën prej 10% të diferencës ndërmjet

shumës së realizuar dhe shumës prej 2.500.000 euro. Në një rast të tillë, ndihma shtetërore do të jepet derisa të arrijë në 50% të shpenzimeve të arsyetuara investuese.

Neni 6 i Propozim-marrëveshjes parashikon që ndihma shtetërore rajonale në mënyrë kumulative nuk mund të jetë më e madhe se 50% e shumës së vërtetuar së shpenzimeve të arsyetuara investuese të realizuara deri në datën e përfundimit të investimit.

Lidhur me nenin 6.2 të Propozim-marrëveshjes, Komisioni thekson në veçanti detyrimin e Dhënësit për të siguruar që shuma e ndihmës shtetërore e dhënë të mos kalojë 50% të shpenzimeve të arsyetuara të investimit.

Komisioni i kujton dhënësit të ndihmës shtetërore detyrimin ligjor që në rast të lidhjes së marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore, Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës t'i dorëzojë Njoftim në kuptim të nenit 13 të Ligjit për kontroll të ndihmës shtetërore.

Komisioni mban të drejtën e ndryshimit të këtij Mendimi, nëse në procedurën e negocimit vjen deri te ndryshimi thelbësor i tekstit të Propozim-marrëveshjes për dhënien e ndihmës shtetërore në lidhje me tekstin që është dorëzuar në Kërkesën për Mendim.

KRYETAR

I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURENCËS

Prof. Dr. Владимир Наумовски